Në bazë të nenit 46 të Ligjit për Planifikim Urbanistik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Veriore" Nr. 32/20, 111/23, 171/24, 224/24, 40/25, 101/25, 101/25 dhe 127/25), Kryetari i Komunës së Likovës, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

për aplikim për anëtarë të

Trupit participativ për planifikim urbanistik në Komunën e Likovës

1. Lënda e Shpalljes Publike:

Aplikacion për anëtarë të Trupit pjesëmarrës për planifikim urbanistik, i cili themelohet me qëllim që të sigurojë gjithëpërfshirje, pjesëmarrje dhe publicitet në procesin e planifikimit urbanistik në teritor të Komunës së Likovës. Trupi pjesmarrës përfaqëson të gjitha interesat dhe grupet e ndryshme të interesit në bashkësinë lokale, përcjell pikëpamjet, mendimet dhe nevojat e qytetarëve dhe personave juridik në procesin e planifikimit urbanistik, monitoron situatën e planifikimit duke ofruar iniciativa, udhëzime dhe sugjerime për përgatitjen e zgjidhjeve të planifikimit, ka një rol konsultativ në procedurën për përgatitjen dhe miratimin e planeve, rishikon programet e planifikimit dhe zgjidhjet e planifikimit të planeve urbanistike në versionin e tyre të punës. Trupi pjesëmarrës ka të drejtë të diskutojë të gjitha çështjet brenda kompetencës së njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe mund të ndikojë në zgjidhjet e planifikimit dhe politikat e zhvillimit hapësinor duke paraqitur mendimet e tij para Këshillit të Komunës.

2. Kushtet për pjesëmarrje në Trupin pjesëmarrës:

Kërkesa për këtë Shpallje Publike mund të paraqitet nga të gjithë personat e interesuar që janë përfaqësues të bashkësive vendore dhe urbane, ose përfaqësues të organizatave joqeveritare nga segmente të ndryshme të jetës urbane, shoqatat e qytetarëve dhe aktivistët civilë nga Komuna Likovë që përfaqësojnë grupe të ndryshme të qytetarëve, qytetarë që janë ekspertë në fushën e planifikimit urbanistik dhe fusha të tjera profesionale thelbësore për planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës së Likovës.

3. Dokumentet që parashtrohen:

— Aplikacion për anëtar të Trupit pjesëmarrës për planifikim urbanistik të Komunës së Likovës (formulari i është bashkangjitur thirrjes),
— Biografi e shkurtër me një shpjegim të mënyrës në të cilën personi i interesuar konsideron se ai/ ajo do të kontribuojë në punën e trupit pjesëmarrës,

- Deklarata për dhënien e pëlqimit për mbrojtjen e të dhënave personale (formulari i I aplikimit),
- Deklaratë për pranimin e kushteve pas kësaj thirrje (formulari i është bashkangjitur thirrjes)
- Dëshmi përkatëse me shkrim për përmbushjen e kushteve për pjesëmarrje nga pika 2 e njoftimit publik (kopje)

Afati dhe vendi i dorëzimit të aplikacioneve:

Aplikimet sipas Shpalljes Publike me dokumentacion të plotë të paraqiten në arkivin e Komunës së Likovës ose me postë në adresën: f. Likovë, Komuna e Likovës, KP 1307 në periudhën nga 25.12.2025 deri në 25.01.2026.

Në aplikacion duhet të theksohet: „ Aplikacion në bazë të shpalljes publike për anëtar të Trupit participativ për planifikim urbanistic në Komunën e Likovës".

4. **Mënyra e punës:**

Mënyra e punës dhe numri I anëtarëve të Trupit pjesëmarrës rregullohen me Rregulloren e Procedurës së Trupit Pjesëmarrës të miratuar nga Këshilli I Komunës së Likovës.

Pjesëmarrja në punën e Trupit pjesëmarrës është mbi baza vullnetare dhe nuk parashihet kompenzim.

5. **Informacion shtesë:**

Personat, aplikimet e të cilëve do të pranohen, do të njoftohen me shkrim.

Kontakt: Jetmir Rexhepi, tel. 071/957-194

KOMUNA E LIKOVËS

Nr. 03-1332/1-25.12.2025

РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
ОПШТИНА ЛИПКОВО
Republic of North Macedonia



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
KOMUNA E LIKOVËS
Municipality of Lipkovo

FORMULAR APLIKIMI

për anëtar të Trupit participativ për planifikim urbanistik të Komunës së Likovës

1. TË DHËNAT PERSONALE

Emri dhe mbiemri:
Data e lindjes:
Vendlindja:
Adresa e banimit:
Numri personal (NVAQ):
Numri i telefonit:
E-mail adresa:

2. PËRFAQËSIMI / KATEGORIA E PJESËMARRJES

[ ] Përfaqësues i bashkësisë vendore
[ ] Përfaqësues i bashkësisë urbane
[ ] Përfaqësues i organizatës joqeveritare
[ ] Përfaqësues i shoqatës së qytetarëve
[ ] Aktivist civil
[ ] Ekspert në fushën e planifikimit urbanistik
[ ] Ekspert në fusha të tjera relevante (specifiko): _____

3. ARSIMI DHE EKSPERIENCA PROFESIONALE

Arsimi:_____

Përvoja profesionale:

4. KONTRIBUTI I PRETENDUAR NË TRUPIN PJESËMARRËS

_____

5. DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA

[ ] Biografi e shkurtër
[ ] Deklaratë për pranimin e kushteve të shpalljes
[ ] Dëshmi për përmbushjen e kushteve (kopje)
[ ] Dokumentacion tjetër (specifiko): _____

6. DEKLARATË

Unë nënshkruari: _____

Deklaroj se të dhënat e dhëna në këtë aplikacion janë të sakta, jam në dijeni se pjesëmarrja në Trupin pjesëmarrës është vullnetare dhe pa kompensim financiar, si dhe jap pëlqimin tim për përpunimin e të dhënave personale në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Data: _____

Nënshkrimi: _____

Njësia e vetqeverisjes lokale: Komuna e Likovës, Adresa: f. Likovë, KP 1307, tel kontakt: 031-463-179/180
e-mail: m_likova@komunaelikoves.gov.mk